



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:127313
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05871963

CAP. Nr..865/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores N.Th. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson S.K., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër debitorit Qeveria e Kosovës - Ministria e Shëndetësisë - SHSKUK-së - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore, për kompensimin e pagave, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të kreditores, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1354/20, i datës 30.12.2022, me datë 14.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditores N.Th. nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1354/20, i datës 30.12.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr. 1354/20, të datës 30.12.2022, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të Apropohet i bazuar prapësimi i debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës - SHSKUK, me seli në Prishtinë, ashtu që anulohet Urdhri për lejimin e

përmbarrimit P.nr.818/20 i datës 28.05.2020, të lejuar nga Zyra Përmbarrimore-përmbarruesit A. M. në Prishtinë, si dhe refuzohet propozimi për përmbarrim, i paraqitur me datë 28.05.2020 nga kreditorja N.Th nga Prishtina. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i kreditores brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditores, të anulohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, të lihet në fuqi urdhri përmbarrimor dhe të detyrohet debitori që në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj kreditores shumën si në propozim, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të propozimit për përmbarrim e gjer në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet procedurale sipas tarifës së OAK-së dhe shpenzimet e tjera të procedurës përmbarrimore, të gjitha në afat në prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së urdhrin për përmbarrim.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), ka gjetur se

Ankesa e kreditores është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i autorizuari i kreditores, në organin përmbarrues ka parashtruar propozim për përmbarrim në bazë të Vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektoratit të Punës në Prishtinë, me numër 01 Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020, me të cilin sipas pohimeve, debitori është detyruar që kreditores t'ia paguaj një pagë jubilarë në shumën prej 449.54 €.

Përmbarruesi Privat duke vepruar sipas propozimit, me Urdhërin Përmbarrimor nën shenjën P.nr.818/20 të datës 28.05.2020, ka lejuar përmbarrimin. Kundër këtij urdhri debitori ka paraqitur prapësim me datën 10.06.2020, me propozim që urdhri për përmbarrim të anulohet dhe propozimi për përmbarrim të hedhet poshtë si i pabazuar.

Me përgjigjen në prapësim të datës 17.09.2020, i autorizuari i kreditores ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, ndërsa urdhri për përmbarrim i Përmbarruesit Privat vërtetohet si i bazuar si dhe të detyrohet debitori që t'ia paguan kreditores shumën prej 156 € si dhe shpenzimet e tjera të procedurës përmbarrimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij urdhri.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim dhe me referim në provat shkresore ka vlerësuar se nuk plotësohen kushtet ligjore për lejimin e përmbarrimit, prandaj me

aktvendimin e atakuar PPP.nr. 1354/20, të datës 30.12.2022, ka vendosur që të shfuqizohet urdhri përmbartimor, P.nr.818/20, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se përmbartuesi privat në këtë rast ka lejuar përmbartimin në bazë të një vendimi administrativ që nuk plotëson kushtet dhe nuk përmban elementet për të qenë titull përmbartues, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat nga nenet 21 dhe 27 të LPP-së. Me nenin 22 par 1 nën paragraf 1.2 të LPP-së është përcaktuar se dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative, mirëpo me këtë dispozitë është përcaktuar se çka konsiderohet dokument përmbartimor, ndërsa një dokument përmbartimor për të shërbyer si titull përmbartues patjetër duhet të përmbaj element e përcaktuara me nenin 27 par. 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbartimor. Me dispozitën ligjore të nenit 27 të LPP, shprehimisht është përcaktuar se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, ndërsa mungesa e njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Në rastin konkret Përmbartuesi Privat, ka lejuar përmbartimin dhe e ka cilësuar si titull përmbartues Vendimin e Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës të lëshuar në procedurë administrative, mirëpo vendimi i tillë nuk mund të konsiderohet titull përmbartues ngase në dispozitiv nuk e përmban shumën e detyrimit, nuk përmban periudhën kohore dhe nuk përmban afatin brenda të cilës duhet të përmbushet detyrimi, ashtu siç është përcaktuar me dispozitën ligjore të sipërcituar. Nga të gjitha arsyet e paraqitura gjykata vlerësoi se është dashur të vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi ngase në këtë rast nuk ka pasur kushte ligjore të iniciohet procedura e përmbartimit dhe të lejohet përmbartimi nga përmbartuesi privat, kjo pasi që vendimi administrativ në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbartimore dhe është lejuar përmbartimi, nuk mund të konsiderohen titull përmbartues ashtu siç është përcaktuar me dispozitat nga nenet 21, 27 dhe 36 të LPP.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 22 paragraf 1, pika 1.2, 24 paragraf 5, 27 paragraf 1, 36 paragraf 1, 37, 38, 43 paragraf 4, 71 dhe 73 paragraf 3 të LPP-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka mbështetur në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore. Prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbartimor ndërkaq, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të

aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbartim, konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i papërshtatshëm për përmbartim nga fakti se me nenin 27 të LPP-së, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim.

Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbartimor - vendimi administrativ i Inspektoriatit të Punës, 01 Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, i cili në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, e që nuk mund të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qëndrojnë pretendimet e prapësimit të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbartueshmërisë së dokumentit përmbartimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj për Gjykatën e Apelit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye bindëse mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.Nr. 865/23, me datë 14.06.2024

Gjyqtarja
Hunaida Pasuli